



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Zhvillohet analiza vjetore e Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore “Mbi performancën dhe impaktin e veprimtarisë audituese të departamentit përgjatë vitit 2019”.

Më datë 05 Shkurt 2020, në ambientet Kontrollit të Lartë të Shtetit u zhvillua analiza vjetore e Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, analizë e realizuar në zbatim të urdhrorit të Kryetarit të KLSH-së nr. 06 datë 23.01.2020 “Për kryerjen e analizave vjetore të Veprimtarisë së Departamenteve të KLSH-së për vitin 2019”. Analiza e Departamentit u drejtua nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, z. Vullnet Karafilaj me pjesëmarrjen e Drejtorit të Përgjithshëm të KLSH-së zj. Manjola Naço dhe Drejtorit të Departamentit të Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, z. Gjovalin Preçi.



Raporti i veprimtarisë u mbajt nga Drejtori i Departamentit z. Vullnet Karafilaj, i cili bëri një përmbledhje të shkurtër të veprimtarisë audituese, duke u përqendruar kryesisht në realizimin e objektivave të vitit 2019, programit vjetor të auditimit të departamentit, rezultatet e punës audituese të shprehur në rekomandime për përmirësim e gjendjes dhe duke ndaluar në masat organizative, ato administrative dhe disiplinore, masat për shpërblimin e dëmit referuar nivelit vleror të tyre, pa anashkalluar kallëzimet apo indicie penale rezultat i punës audituese të departamentit apo materialet që i janë drejtuar organit të prokurorisë për vlerësim.

Në raport u theksua se auditimet e kryera kanë pasur për qëllim që nëpërmjet gjetjeve dhe rekomandimeve të lëna në përfundim të çdo auditimi të minimizojnë deri në eliminim të parregullsive duke dhënë ndikim pozitiv në përmirësimin e punës të subjekteve të audituara. Fokus të veçantë pati veprimtaria e audituesve të departamentit në drejtim të realizimit të “Auditimeve Financiare” dhe të “Auditimeve të Përputhshmërisë”, cilësisë së auditimeve, pjesëmarrjes së audituesve në trajnime, pjesëmarrjes në median e shkruar, ...etj.

Për vitin 2019 nga 28 auditime të programuar/planifikuar janë realizuara dhe evaduar 31 auditime, pra 3 auditime mbi planin vjetor. Auditimet kanë mbuluar një periudhë aktiviteti 2-3 vjeçare (viti 2017-2018 dhe 9/mujori 2019). Kështu, janë audituar 24 bashki nga të cilat 5 bashki të mëdha dhe 19 bashki të mesme e të vogla. Janë realizuar 3 auditime në njësi varësie të Bashkisë Tiranë dhe 4 (katër) auditime tematike. Sipas llojit të auditimit nga departamenti janë zhvilluar 19 auditime të kombinuara “Auditim Financiar dhe i Përputhshmërisë¹” (kryesisht për prokurimet publike), 6 “Auditime Financiare”, 4 “Auditime të Përputhshmërisë” dhe 2 “Auditime Tematike”.

Në subjektet e audituara për vitin 2019, janë rekomanduar 345 masa organizative, 119 masa për shpërblim dëmi në vlerën prej 128 milion lekë, masa për eliminimin e shpenzimeve jo në përputhje me

¹ Kryesisht për procedurat e prokurimit të investimeve/mallrave dhe shërbimeve

kuadrin ligjor dhe parimet e efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomicitetit në vlerën prej 5,600 milion lekë, si dhe 258 masa disiplinore dhe administrative.

Dëmi prej 128 milion lekësh sipas fushave ndahet në: *81 milion lekë në fushën e prokurimeve publike (2.4 milion në shkelje të procedurave dhe 78.5 milion në fushën e zbatimit të kontratave), 36 milion lekë fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore; 8.6 milion lekë në fushën e administrimit të aseteve, 418 mijë lekë në pagesa të kundërligjshme për shpenzimet operative dhe 1.7 milion lekë në zërin të tjera.* Vlera prej 5,600 milion lekë e shpenzimeve jo në përputhje me kuadrin ligjor dhe parimet e efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomicitetit përfaqëson të ardhura të munguara në fushën e tatim taksave në subjektet e vetëqeverisjes vendore, në administrimin e aseteve dhe urbanistikës, si dhe shpenzime në fushën e prokurimeve publike të realizuara në shkelje të kërkesave ligjore lidhur me prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

Për të gjitha shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara, janë rekomanduar 258 masave disiplinore dhe administrative, nga të cilat: *97 masa disiplinore për punonjës pjesë e shërbimit civil (status nëpunësi), 48 masa për punonjës me kodin e punës, si dhe 113 masa administrative prej të cilave 22 masa administrative në kompetencë të IMTV^{ve}, 89 masa administrative në kompetencë të APP-së, si dhe dy heqje licence (masa të rekomanduara për 12 subjekte). Masat administrative të vendosura nga APP, për subjektet e adresuara nga KLSH, kanë rezultuar në shumën prej 7.1 milion lekë.*

Nga departamenti janë rekomanduar 7 indicie penale si dhe 1 vlerësim për kallëzim penal, të cilat i janë dërguar organit prokurorisë. Kallëzimet janë adresuar për konsumimin e figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 dhe “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike” neni 258, dhe në dy raste për falsifikim dokumentesh, neni 186 të Kodit Penal.

Nga departamenti janë trajtuar edhe **39 ankesa**, nga shqyrtimi i tyre ka rezultuar se kryesisht ankesat e drejtuar janë jashtë kompetencave të KLSH-së (25 ankesa), megjithatë nga departamenti është bërë adresimi i tyre në institucionet përgjegjëse, me qëlimin e mirë ardhjen në ndihmë të qytetarëve dhe rritjen e besimit të tyre të institucionit të KLSH-së; në 10 raste nisur nga problematikat e bëra prezent është bërë regjistrimi i ankesave si indicie për auditim; dhe në 4 raste ankesat kanë rezultuar të drejta dhe departamenti i ka trajtuar ato duke dhënë edhe rekomandimet respektive për përmirësimin e situatës.

Gjatë vitit 2019, departamenti i auditimit të pushtetit vendor ka treguar kujdesin dhe përkushtimin e duhur, që në zbatim të standardeve të marrë pjesë në mënyrë sistematike në të gjitha trajnimet e realizuara nga KLSH, por dhe institucione të tjera brenda vendit apo edhe jashtë. Rezultati i kësaj pune vjetore është se çdo auditues jo vetëm ka plotësuar objektivin e trajnimeve, 20 ditë trajnimi/vit, por dhe ka përditësuar njohuritë e fituara për secilën fushë. Kujdes është treguar veçanërisht për trajnimin e audituesve të rinj, duke arritur objektivin e trajnimit për audituesit e rinj 21 ditë trajnimi/vit. Për audituesit e rinj jemi kujdesur që për çdo rast të përfshihen në grupe auditimi me auditues me eksperiencë në auditim.

Po ashtu në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të KLSH për prezencën e audituesve të KLSH në median e shkruar, urdhri i mbështetur në standardet ISSAI për komunikimin me publikun e gjerë dhe me qëllim rritjen e transparencës, auditues të departamentit kanë botuar mesatarisht 1 deri në 2 artikuj në median e shkruar.

Pas prezantimit të punës të Departamentit, fjalën e mori Drejtori i Përgjithshëm zj. Manjola Naço, e cila përgjithësisht u përqendrua në një përmbledhje të problematikave të hasura gjatë evadimit të materialeve të auditimit, punën e bërë për korrigjimin e tyre dhe masat që duhen marrë për eliminimin e mangësive përgjatë aktivitetit të vitit 2020. Në fjalën e saj zj. Naço, adresoj edhe objektivat kryesore që duhet të drejtojnë aktivitetin auditues për vitin, duke theksuar nevojën e zbatimit më të mirë të Rregullores për Procedurat e Auditimit në KLSH, zbatimit të standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe veçanërisht manualeve për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë në drejtim të standardizimit dhe unifikimit të procedurave të auditimit, për arritur një produkt auditimi në përputhje me parimet e profesionalizmit, objektivitetit dhe integritetit. Është e rëndësishme, sipas saj, që secili grup auditimi të bëjë një analizë riskut të kujdesshme me qëllim hartimin e programeve të auditimit sipas

karakteristikave të subjektit për të mbuluar me auditim zonat me risk më të lartë dhe për formuluar opinione auditimi plotësisht të bazuara në standardet e auditimit.

Më pas fjalën e mori Drejtori i Departamentit të Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, z. Gjovalin Preçi, i cili theksoj në mënyrë të përgjithshme problematikat e konstatuara gjatë kontrollit të cilësisë të dosjeve të auditimit. Në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të KLSH-së nr. 130, datë 26.12.2019 *“Për kontrollin e sigurimit të cilësisë në procesin e auditimit për vitin 2019”*, fjalën e mori znj. Miranda Haxhia e cila bëri prezent problematikat e konstatuara gjatë procesit të kontrollit të cilësisë për 7 dosje të marrë për vlerësim, problematika të cilat kryesisht i përkasin fazës së planifikimit të auditimit/hartimit të programeve; fazës së kryerjes së auditimit; si dhe fazës së raportimit dhe evadimit të materialeve.

Pas kësaj, sipas traditës disa vjeçare u bë paraqitja e referimeve të dy kryeaudituesve, disa prej audituesve me përvojë si dhe të audituesve të rinj të departamentit. Lolita Baholli (Kryeaudituese) referoi temën *“Problematika me risk në fushën prokurimit publik”* dhe *“Auditimi i NJQV Bashkia Has”*. Alush Zaçe (Kryeauditues) referoi temën *“Auditimi i zbatimit të kontratave dhe sfidat për KLSH”*. Albert Thoma (Auditues i Lartë) referoi temën *“Auditimi i taksave dhe tarifave vendore”*. Berti Meçe (Auditues i Lartë) referoi temën *“Qëndrueshmëria financiare e njësisve të vetëqeversjes vendore dhe llojet e opinioneve të auditimit shpjeguar përmes rastit të Bashkisë Libohovë”*. Albert Hoxhalli (Auditues i Dytë) referoi nga kolona e botimeve të KLSH *“Manuali Financiar”*. Enea Caushaj (Auditues i Dytë) referoi temën *“Materialiteti dhe Risku në Auditimin Financiar, Testet”*. Shkëlzen Hoxha (Auditues i Dytë) referoi temën e lirë *“Eksperiencia një vjeçare në KLSH dhe sfidat për të ardhmen”*.



Në fund nga Drejtori i Departamentit u prezantuan objektivat e departamentit për vitin 2020.

